



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:109438

Datë: 25.09.2024

Numri i dokumentit: 06208481

PA1.nr.1120/24

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Zyhdi Haziri kryetari i kolegjit, Violeta Husaj Rugova dhe Skender Çoçaj anëtarë, me pjesëmarrjen e praktikantes Gjqësore në cilësi të procesmbajtëses Fitore Zeka, në çështjen penale kundër të pandehurit Sh. K. nga fshati Blaq Komuna e Dragashit, për vepër penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore në Prizren Pejë, të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prizren Dega Dragashë P.nr.44/20 të datës 27.07.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me 11.09.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

-HUDHET si e palejueshme ankesa e Prokurorisë Themelore në Prizren PP.II.nr.1093-9/2020 të datës 26.06.2024, e paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prizren dega Dragash P.nr.44/20 të datës 27.07.2023, pasi që prokuroi i Prokurorisë së Apelit ka heq dorë nga ankesa.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren dega në Dragash, gjegjësisht gjyqtari i çështjes, me aktgjykim P.nr.44/20 të datës 27.07.2023 e ka refuzuar aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Prizren Departamenti për Krime të Përgjithshme PP.II.nr.1093-9/2020 të datës 17.07.2020 (e shënuar nga gjykata themelore PP.II.nr.1880-3/19 e datës 10.09.2019 në hyrje dhe në arsyetim të

aktgjykimit, të cilin gjykata e ka konsideruar si gabim teknik) ndaj të akuzuarit Sh. K. nga fshati Blaq Komuna e Dragashit, për shkak se nuk është vërtetuar-nuk është provuar se i pandehuri ka kryer veprën penale si më lartë për të cilin akuzohet. E dëmtuara, KEDS-Distrikti në Prizren, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil. Shpenzimet procedurale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës, konform nenit 453 të KPP-së.

Kundër këtij aktgjykimi të cekur si më lartë, ankesë ka ushtruar Prokuroria Themelore në Prizren PP.II.nr.1093-9/2020 të datës 26.06.2024, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës penale dhe vlerësimit të gabuar ose jo të plotë të fakteve mbi të cilat është nxjerrë aktgjykimin i gjykatës së shkallës së parë, me propozim që Gjykata e Apelit të anuloj aktgjykimin e atakuar dhe çështjen ta kthej në rivendosje.

Prokurori i Apelit në Prishtinë, me parashtresën me shkrim PPA/II.nr.1120/2024, datë 19.07.2024, ka heq dorë nga ankesa e Prokuroria Themelore në Prizren PP.II.nr.1093-9/2020 të datës 26.06.2024, e paraqitur kundër aktgjykimit të lartcekur për shkak se ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale. Parashkrimi absolut ka ndodhur pasi që vepra penale është kryer në një kohë relativisht të gjatë dhe atë me dt.13.02.2018 dhe nga jo kohë e deri më tani kanë kaluar më tepër se 6 vite nga kryerja e veprës penale e që për këtë vepër penale është paraparë dënimi me gjobë ose me burgim deri në tri vite ashtu që për këto vepra penale sipas nenit 106 par. 1 nën par. 1.5 të KPRK-së, ka arrit parashkrimi i ndjekjes penale, duke marrë parasysh që sipas nenit 1.5 të këtij neni afati i parashkrimi për vepra të dënueshme më me shumë se një vit është parapara afati prej 3 vitesh nga kryerja e veprës penale. Andaj meqë ka arritur parashkrimi absolut heq dorë nga ndjekja penale nga neni 107 par. 8 të KPRK-së i cili parasheh që ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohë së afatit të parashkrimit.

-Kolegji i kësaj gjykate pas marrjes së parashtresës nga ana e Prokurorisë së Apelit në Prishtinë të cekur si më lartë, ka vendosur se konform nenit 400 të KPPRK-së ankesa të hudhet si e palejueshme meqë sipas kësaj dispozite ligjore parashihet që: *“Gjykata e Apelit me aktvendim e hedh ankesën si të palejueshme kur konstaton se është paraqitur nga personi pa të drejtë ankese ose nga personi që ka hequr dorë nga ankesa, apo kur ankesa është tërhequr, ose kur ankesa e tërhequr paraqitet sërish apo ankesa nuk është e lejuar me ligj”*.

Numri i lëndës: 2020:109438
Datë: 25.09.2024
Numri i dokumentit: 06208481

Nga sa u tha më lartë, e konform dispozitës së nenit 400 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT PRISHTINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL

2020:109438, 25.09.2024

Praktikantja Gjyqësore

Fitore Zeka

Kryetari i kolegjit

Zyhdi Haziri